



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KRYETAR

Nr. 11508 prot.

Vlorë, më 14 07 2025

URDHËR I BRENDSHËM
Nr. 295, datë 14 07 .2025

**“MBI KUFIZIMET NË QARKULLIMIN E MJETEVE TË RËNDA PËR
TRANSPORTIN RRUGOR TË MALLRAVE SI DHE DISIPLINIMIN E
PUNIMEVE TË NDËRTIMEVE GJATË SEZONIT TURISTIK”**

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” Neni 8, Neni 9.1, pika 1.1/a dhe b, neni 23, pika 9, neni 64, pika a dhe gj, ligjit nr.93/2015, datë 27.07.2015 “Për Turizmin”, në Udhëzimin e përbashkët nr. datë “Mbi kufizimet në qarkullimin e mjeteve të rënda për transportin rrugor të mallrave përgjatë sezonit turistik dhe festave;

U R D H Ë R O J:

- 1- Për periudhën 15 Korrik -15 Shtator ndalohet qarkullimi i mjeteve të rënda mbi 3,5 ton në aksin Vlorë-Zvërnec-Vlorë deri në Njësinë Administrative Orikum, si më poshtë:

Dita e Premte nga ora 15:00 - deri në orën 24:00

Dita e Shtunë nga 06:00- deri në orën 24:00

Dita e Dielë nga ora 06:00-deri në orën 24:00

a.Përfshihen nga ky kufizim i qarkullimit të mjeteve të rënda si më poshtë:

-Kamion që transportojnë ushqime që prishen të tilla si mish i freskët qumësht i papërpunuar dhe të produkteve të qumështit të freskët, peshk të freskët dhe prodhimeve të detit, fruta dhe perime që prishen.

-Kamion që transportojnë shpend dhe bagëti të gjalla

-Mjete për mallrat e destinuara për ushqimin e kafshëve të fermave, për periudha të nevojshme për zgjidhjen e kritikës së furnizimit.

- 2- Për periudhën 15 Korrik-15 Shtator lejohet qarkullimi i mjeteve si dhe furnzim/shkarkim i mjeteve nga 1,5 ton-3.5 ton në të gjithë segmentet rrugore të qytetit të Vlorës si më poshtë:

Dita e Hënë nga ora 11:00-15:00 dhe 01:00-06:00 të ditës së Martë

Dita e Martë nga ora 11:00-15:00 dhe 01:00-06:00 të ditës së Mërkurë

Dita e Mërkurë nga ora 11:00-15:00 dhe 01:00-06:00 të ditës së Enjte

Dita e Enjte nga ora 11:00-15:00 dhe 01:00-06:00 të ditës së Premte

Dita e Premte nga ora 11:00-15:00 dhe 01:00-06:00 të ditës së Shtunë

Dita e Shtunë nga ora 01:00-06:00

Dita e Dielë nga ora 01:00-06:00

- 3- Për periudhën 15 Korrik -15 Shtator ndalohet parkimi i mjeteve mbi 3.5 ton dhe i kamperave në të dy anët e rrugës “Gjergj Kastrioti”, Rruga “ Pelivan Leskaj”, “Lungomare”, Bulevardi “Ismail Qemali”, “Hasan Kushta”, “Dervish Hekali”, “Demokracia”, “Anita Bitri”, “Hysni Alimerko”, “Lef Sallata”, “Sulejman Delvina”, si dhe Rruga “Mustafa Bello”..
- 4- Përjashtohen nga ky urdhër vetëm automjetet e lejuara sipas VKB nr. 35, datë 28.04.2022 “ Mbi përcaktimin e vendparkimeve të mjeteve të transportit rrethqytetës, interurban dhe ndërkombëtar në qytetin e Vlorës”.
- 5- Pezullimin e përkohshëm të punimeve, të subjekteve që janë pajisur me leje ndërtimi për periudhën 15.07.2025-15.09.2025.
- 6- Të ndalohet për periudhën 15.07.2025-15.09.2025, qarkullimi i mjeteve rrugore të rënda që shërbejnë për transportin e materialeve të ndërtimit (auto betoniere, autovinca, eskavator, kamion etj) në territorin e Bashkisë Vlorë.

Për zbatimin e këtij Urdhëri ngarkohet Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike si edhe Policia Bashkiake .

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë!


KRYETAR
Ermal Dredha